

SCAN
MAGAZINE

INDUSTRIA BANKARE

ZGJIDHJET JANË ATY

Kredia nuk është aq e shtrënguar

FAQE 10

“Mollët e pandalueme” të Dibrës

FAQE 34

Si do pushojmë këtë verë?

FAQE 38

Kur paratë e pensioneve tepronin për kredi

FAQE 51

Profesionistët në Albania Fashion Awards 2019

FAQE 72

Gjatë 2018

pranë Bursës ALSE janë anëtarësuar katër shoqëri komisionere Banka, të licensuara nga AMF, për të kryer veprime me tituj. Banka Credins, Banka Amerikane e Investimeve dhe Tirana Bank janë të licensuara për kryerjen e veprimeve me tituj për llogari të tyre dhe të klientëve (broker-dealer)



ALSE, një vit nga aktiviteti i bursës shqiptare

Në rrugën për të qenë aktor i rëndësishëm, brenda industrisë së titujve.

Bursa shqiptare tashmë funksionale, ALSE është në rrugën e saj të zhvillimit e përqëndruar në synimin e saj kryesor që të bëhet një aktor i rëndësishëm, brenda industrisë së titujve, në përputhje me praktikat më të mira të tregjeve të zhvilluara. Institucioni i rëndësishëm i tregut financiar shqiptar planifikon që këtë vit të bëjë listimin e titujve të emetuar nga korporatat e para private ose shtetërore, të kuotojë të gjithë titujt e borxhit korporativ ekzistues në treg, të emetuara me ofertë private. Mbi këtë bazë arrihet krijimi i një tregu sekondar likuid, për titujt korporativë ekzistues dhe për titujt e rinj që do të emetohen. Materializimi dhe zgjerimi i aktivitetit është fokusuar tek tërheqja e ndërmjetësve financiarë (shoqërive komisionere, banka ose jo banka) drejt një tregu të rregulluar dhe të organizuar, për të ofruar një dritare likuiditeti, që shoqërohet me transparencë të lartë në kryerjen e transaksioneve. Në një periudhë më afatgjatë ALSE synon që të kryejë ofertën e parë publike në vendin tonë, duke i dhënë mundësi të gjithë

investitorëve të alokojnë fondet e tyre të lira në instrumente të tjerë, përtej atyre tradicionalë. Ky do të ishte një hap cilësor drejt krijimit të një tregu transparent, eficient, të mirë rregulluar e të paanshëm i cili t'u mundësojë operatorëve të tregut një kosto sa më të ulët ndërmejtësimi. Arritja e këtyre synimeve e kanë tashmë një bazë të materializuar në aktivitetin që ALSE ka kryer deri më tani, dhe vecanërisht në arritjet e vitit 2018, të cilat janë zyrtarizuar së fundmi në raportin vjetor të institucionit.

Antarësimi

Gjatë vitit 2018 pranë Bursës ALSE janë anëtarësuar katër shoqëri komisionere Banka, të licensuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për të kryer veprime me tituj në Republikën e Shqipërisë. Këta anëtarë

plotësuan me sukses të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, të kërkuar nga rregullorja e Bursës ALSE, si dhe përfunduan me sukses të gjithë procesin e instalimit të sistemit të tregtimit pranë mjediseve të tyre, me qëllim aksesimin sa më të lehtë prej brokerave fizikë të tyre. Tre nga katër anëtarët: Banka Credins, Banka Amerikane e Investimeve dhe Tirana Bank janë të licensuara nga AMF për kryerjen e veprimeve me tituj për llogari të tyre dhe të klientëve (broker-dealer), ndërkohë që Banka Ndërkombëtare Tregtare zotëron licensë për kryerjen e transaksioneve vetëm për llogari të vet (dealer). Gjithashtu, gjatë vitit 2018 ka patur një interes në rritje nga Shoqëritë Komisionere jo-Banka, të licensuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për t'u anëtarësuar pranë Bursës ALSE,

për tregtimin e titujve të borxhit të Qeverisë (bono dhe obligacione thesari), për llogari të klientëve. Ky proces shoqërohet me një sërë problematikash teknike, të hasura në drejtim të marrëdhënieve operacionale mes operatorëve të tregut “bursë – shoqëri komisionere jo-bankë – agjent shlyerës (kujdestar titujsh)”. Bursa ALSE është duke ndjekur me vëmendje procesin dhe ka mbështetur operatorët, në drejtim të lehtësimit të procedurave, si dhe në monitorimin e rrezikut operacional që mund të sjellë kjo veprimtari, me qëllim ruajtjen e integritetit të tregut dhe mbrojtjen sa më të mirë të interesave të investitorëve.

Listimi

Me vendimin nr. 88, datë 03.7.2017 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Bursa Shqiptare e Titujve ALSE është kufizuar që gjatë vitit të parë të veprimtarisë të tregtojë vetëm tituj të borxhit të Qeverisë (bono dhe obligacione thesari). Ky kufizim i AMF-së erdhi për shkak të mungesës në tregun vendas të infrastrukturës së nevojshme për klerimin dhe shlyerjen e titujve, të emetuar nga biznesi. Licenca e Bursës Shqiptare të Titujve ALSE është e plotë dhe kufizimi i tregtimit vetëm në tituj të borxhit të Qeverisë de-jure përfundon 1 vit nga data e fillimit të tregtimit në bursë, ndërsa de-facto, pasi rregullatorët të kenë licensuar institucionet financiare, të nevojshme për klerimin dhe shlyerjen e titujve të emetuar nga korporatat. Gjatë vitit 2018, Bursa ALSE ka vijuar me listimin periodik të titujve të Qeverisë, të emetuar në tregun primar të ankandëve të Bankës së Shqipërisë, sipas kalendarit të maturimit të shpallur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Titujt listohen në Bursën ALSE në të njëjtën ditë që përfundon ankandi në tregun pri-

mar dhe operatorët e tregut, së bashku me investitorët mund të realizojnë transaksione blerje-shitje në tregun sekondar të bursës në të njëjtën ditë, por me afat shlyerje dy ditë pas datës së tregtimit.

Tregtimi

Bursa Shqiptare e Titujve ALSE e ka nisur tregtimin në titujt qeveritarë në 22 shkurt 2018 me 2 ditë në javë, përkatësisht çdo të martë e të enjte. Me zhvillimin e tregut dhe zgjerimin, si të klasave të instrumenteve të tregtimit, ashtu edhe të numrit të bankave, apo firmave të brokerimit që do të tregtojnë në ALSE, do të shtohet edhe numri i ditëve të tregtimit deri në 5 ditë në javë, siç është në të gjithë bursat në mbarë botën. Pavarësisht këtij fakti, individët, apo sub-

jektet që duan të tregtojnë bono dhe obligacione thesari, mund ta bëjnë këtë edhe në ditët e tjera, nëpërmjet Bankave dhe Shoqërive Komisionere që janë Anëtare në Bursën Shqiptare të Titujve, por më parë duhet të kenë hapur një llogari në cash dhe në tituj, si dhe të kenë nënshkruar një kontratë për transaksionet që do kryejnë me këto banka. Volumet dhe vlerat e tregtimit të titujve, gjatë vitit 2018, janë të kënaqshme. Ky element shënon një gur themeli të zhvillimit të tregut sekondar të organizuar të titujve në vend, si dhe një ndër shtyllat kryesore të zhvillimit të tregut të kapitaleve në përgjithësi. Përtej transaksioneve në tituj të borxhit të Qeverisë të emetuara në monedhën vendase, në muajin korrik 2018 në Bursën Shqiptare të Titujve ALSE u tregtua,

“

Në periudhën shkurt - dhjetor 2018, vlera e tregtimit në Bursën Shqiptare të Titujve ALSE arriti në nivelin e 2.57 miliardë lek, ose rreth 20.8 milionë euro, me një sasi prej më shumë se 106,700 njësi titujsh të tregtuar dhe një numër total prej 127 transaksionesh


”



ALBANIAN SECURITIES EXCHANGE
BURSA SHQIPTARE E TITUJVE

Volumi i Tregtimeve / Volume of Trades

Shkurt - Dhjetor 2018 / February - December 2018





për herë të parë një Obligacion The-sari 2 vjeçar i emetuar në euro. Kjo ishte një risi për tregun, pasi procesi i klerimit dhe shlyerjes së këtij transaksioni nuk ishte testuar më parë nga operatorët (bursa – kujdestarët - AF-IsaR) në një sesion tregtimi të drejt-përdrejtë. Transaksioni u ekzekutua me sukses, pa probleme teknike në asnjë nga hallkat “tregtim-klerim-shlyerje”. Tregtimet në titujt e emetua-ara në monedhë të huaj nuk janë të preferuara nga operatorët e tregut dhe anëtarët e bursës, për shkak të kostove shumë të larta të transfertave ndërbankare në procesin e shlyerjes së vlerave monetare.

Rezultatet

Gjatë vitit të parë të veprimtarisë, në periudhën shkurt - dhjetor 2018, vlera e tregtimit në Bursën Shqiptare të Titujve ALSE arriti në nivelin e 2.57 miliardë lek, ose rreth 20.8 milionë euro, me një sasi prej më shumë se 106,700 njësi titujsh të tregtuar dhe një numër total prej 127 transaksionesh. Gjatë kësaj periudhe në Bursën Shqiptare të Titujve ALSE kanë mbizotëruar: transaksionet mes bankave, transaksionet në oraret zyrtare, transaksionet në obligacione thesari dhe transaksionet në lekë. Nga një analizë e transaksioneve të kryera rezulton që: Pjesa më

Në një periudhë më afatgjatë ALSE synon që të kryejë ofertën e parë publike në vendin tonë, duke i dhënë mundësi të gjithë investitorëve të alokojnë fondet e tyre të lira në instrumente të tjerë, përtej atyre tradicionale. Ky do të ishte një hap cilësor drejt krijimit të një tregu transparent dhe eficient.

e madhe e numrit të transaksioneve të zhvilluara gjatë vitit të parë të veprimtarisë janë transaksione në tregun me pakicë, krahasuar me transaksionet ndërbankare. Transaksionet në tregun me pakicë janë transaksione që kryhen ndërmjet bankës dhe klientëve dhe klientëve midis tyre. Transaksionet mes bankave të realizuara në Bursë janë mbizotëruese në vlerën e tregut, 55.6% e totalit, dhe në sasinë e tregtuar të titujve, 69.8% e totalit. Ndërkohë, si numër transaksionesh janë kryer më shumë transaksionet që realizojnë bankat me klientët, apo klientët me njëri-tjetrin që janë 63% e totalit. Pjesa më e madhe e transaksioneve janë të ekzekutuara në obligacione thesari, krahasuar me transaksio-net në bono thesari. Gjatë 2018 sa i përket sasisë të tregtuar, mbizotëruan bonot e thesarit me 85.1% e totalit, ndërsa mbizotërim thelbësor, për sa i përket numrit të transaksioneve dhe vlerës së tregtuar, ishin transaksionet në obligacione thesari. Konkretisht, sipas vlerës së tregtuar obligacionet zunë 64.9% të totalit dhe rreth 66.9% të totalit të numrit të

transaksioneve të realizuara në bursë. Sipas orareve të ekzekutimit, pjesa më e madhe e transaksioneve wshtw ekzekutuar On-Exchange. Transaksionet e ekzekutuara në oraret zyrtare mbi-zotërojnë, në drejtim të vlerës së tregut me 53.6% e totalit, sasisë së tregtuar të titujve (80.0% e totalit) dhe numrit të transaksioneve (53.5% e totalit). Transaksionet e realizuara në oraret zyrtare (On-Exchange) janë transaksione që kanë një nivel shumë herë më të lartë transparence. Ndërkohë, tregu me pakicë, apo tregu mbi banak (jashtë orareve zyrtare të tregtimit në bursë), karakterizohet nga transaksione të ekzekutuara në kushte të mungesës së trasparencës për klientët, duke krijuar një ndikim jo pozitiv mbi çmimet e titujve. Parë në këndvështrimin e maturimit nga bonot e thesarit, titujt më aktivë janë ato me maturim 12 mujor, të ndjekura nga bono thesari 6 mujore, ndërkohë që mungojnë transaksione në bono thesari 3 mujore sepse afati i tyre i maturimit është shumë i shkurtër. ■